

V E N D I M
Nr. 496, datë 21.9.2000

**PËR TRAJTIMIN ME PAGESË MINIMALE TË PUNONJËSVE TË FABRIKËS SË
ÇIMENTOS, VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 53, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të nenit 21 dhe 27, të ligjit 8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, të ministrit të Punëve Publike dhe të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit e fabrikës së çimentos, në Vlorë, të cilët deri më datën 30.4.1998 kanë qenë në marrëdhënie pune, përfitojnë një vit pagë minimale, në mbështetje të vendimit nr.203, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi".

Kjo pagesë ndërpritet për punonjësit të cilët kryejnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit dhe të vetëpunësimit, brenda periudhës së trajtimit me këtë pagesë.

Pagesa për këta punonjës të kryhet nga zyra e punës e rrethit të Vlorës.

2. Fondi prej 21 milionë lekësh për pagesën e këtyre punonjësve të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave. Periudha njëvjeçare për punonjësit që përfitojnë sipas këtij vendimi, të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni dhe të shënohet si e tillë në librezën e punës.

3. Fondi për detyrimet kontributive të papaguara për sigurimet shoqërore, të periudhës para datës 30.4.1998, të cilat arrijnë shumën 20 600 000 lekë, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga pagesa e qirasë së këtij objekti, e cila, për një vit, do të përdoret e gjitha për këtë qëllim.

4. Ministria e Punëve Publike të marrë masa për administrimin e dokumentacionit të fabrikës së çimentos, Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta